L I G J
Nr.9011, datë 20.2.2003

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË, TË FINANCIMIT DHE TË PROJEKTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT DHE KFW-SË PËR PROJEKTIN "FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE, II""

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 shkronja "ç" të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,80

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e huasë, e financimit dhe e projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW-së për projektin "Fondi i investimeve sociale, II"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3735, datë 19.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
FINANCIMI, HUAJE DHE PROJEKTI NDËRMJET
KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU, FRANKFURT AM MAIN ("KFW")
DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ("HUAMARRËSI") PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE FONDI I ZHVILLIMIT SHQIPTAR ("AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT") PËR 2.045.167,52 EURO SI KREDI
DHE 255.645,94 EURO SI KONTRIBUT FINANCIAR

Fondi i investimeve sociale, II

Në bazë të një Marrëveshjeje që do të përfundohet ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale Gjermane dhe Qeverisë së Shqipërisë për bashkëpunim financiar ("Marrëveshje Qeveritare"), Huamarrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW hyjnë në Marrëveshjen e huasë, financimit dhe projektit si më poshtë:

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i huasë/kontributit financiar

1.1 KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një kredi jo më shumë se 2.045.167,52 euro dhe një kontribut financiar jo më shumë se 255.645,94 euro.

Kontributi financiar nuk do të jetë i kthyeshëm përderisa të kushtëzohet ndryshe në nenin 5.3.

1.2 Huamarrësi do ta kanalizojë huanë plotësisht për Agjencinë e Zbatimit të Projektit në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit do ta përdorë Kredinë vetëm për financimin e projekteve të vogla të infrastrukturës ekonomike dhe sociale dhe kontributin financiar për trajnim dhe trajnime të mëtejshme të inspektorëve social të FZHSH-së, dhe së pari për të paguar koston e këmbimit të huaj. Të dyja së bashku përbëjnë projektin. Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW do të përcaktojnë hollësitë e projektit dhe mallrat e shërbimet që do të financohen nga huaja/ kontributi financiar me një marrëveshje të veçantë.

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që do të lindin nga Huamarrësi ose Agjencia e

Zbatimit të Projektit dhe taksat e importit nuk do të financohen nga kredia.

Neni 2

Kanalizimi i huasë për Agjencinë e Zbatimit të Projektit

2.1 Huamarrësi do ta drejtojë huanë dhe kontributin financiar tek Agjencia e Zbatimit të Projektit si një kontribut financiar të pakthyeshëm sipas një marrëveshjeje të veçantë.

2.2 Para disbursimit të parë nga huaja dhe kontributit financiar, Huamarrësi do t'i dërgojë KfW-së një kopje të Marrëveshjes së huasë specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i huasë nuk përbën ndonjë detyrim të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrime pagesash sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3
Disbursimet

3.1 KfW-ja do të disbursojë huanë dhe kontributin financiar në përputhje me ecurinë e projektit dhe me kërkesën e Agjensisë së Zbatimit të Projektit. Me një marrëveshje të veçantë, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të bien dakord mbi procedurat e disbursimit, në veçanti mbi evidencën që provon se shumat e kërkuara janë përdorur për qëllimin e caktuar.

3.2 KfW-ja do të ketë të drejtën të refuzojë bërjen e disbursimeve pas datës 31 dhjetor 2006.

Neni 4
Tarifa e angazhimit, interesi dhe shlyerja

4.1 Huamarrësi duhet të paguajë një tarifë angazhimi prej ¼% në vit mbi shumat e huasë së padisbursuar. Ky detyrim angazhimi do të llogaritet për një periudhë duke filluar tre muaj mbas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe duke përfunduar në datën në të cilën janë debituar disbursimet.

4.2 Huamarrësi do të paguajë interesin mbi kredinë në shkallën prej 0.75% në vit.

Interesi do të ngarkohet që nga datat në të cilat janë debituar disbursimet, deri në datat në të cilat janë kredituar shlyerjet në llogarinë e KfW-së, specifikuar në nenin 4.9.

4.3 Huamarrësi do të paguajë detyrimin e angazhimit, interesin dhe ndonjë interes mbi shumat e papaguara në bazë gjashtëmujori sipas nenit 4.5, më 30 qershor për gjashtëmujorin e I-rë dhe 30 dhjetor për gjashtëmujorin e II-të. Pagesa e parë do të paguhet së bashku me pagesën e parë të interesit.

4.4 Huamarrësi do të shlyejë kredinë si më poshtë :

Këstet	Data			Shuma
1	30 dhjetor	2012	euro	34.000.00
2	30 qershor	2013	euro	34.000.00
3	30 dhjetor	2013	euro	34.000.00
4	30 qershor	2014	euro	34.000.00
5	30 dhjetor	2014	euro	34.000.00
6	30 qershor	2015	euro	34.000.00
7	30 dhjetor	2015	euro	34.000.00
8	30 qershor	2016	euro	34.000.00
9	30 dhjetor	2016	euro	34.000.00
10	30 qershor	2017	euro	34.000.00
11	30 dhjetor	2017	euro	34.000.00
12	30 qershor	2018	euro	34.000.00
13	30 dhjetor	2018	euro	34.000.00
14	30 qershor	2019	euro	34.000.00
15	30 dhjetor	2019	euro	34.000.00
16	30 qershor	2020	euro	34.000.00
17	30 dhjetor	2020	euro	34.000.00

18	30 qershor	2021	euro	34.000.00
19	30 dhjetor	2021	euro	34.000.00
20	30 qershor	2022	euro	34.000.00
21	30 dhjetor	2022	euro	34.000.00
22	30 qershor	2023	euro	34.000.00
23	30 dhjetor	2023	euro	34.000.00
24	30 qershor	2024	euro	34.000.00
25	30 dhjetor	2024	euro	34.000.00
26	30 qershor	2025	euro	34.000.00
27	30 dhjetor	2025	euro	34.000.00
28	30 qershor	2026	euro	34.000.00
29	30 dhjetor	2026	euro	34.000.00
30	30 qershor	2027	euro	34.000.00
31	30 dhjetor	2027	euro	34.000.00
32	30 qershor	2028	euro	34.000.00
33	30 dhjetor	2028	euro	34.000.00
34	30 qershor	2029	euro	34.000.00
35	30 dhjetor	2029	euro	34.000.00
36	30 qershor	2030	euro	34.000.00
37	30 dhjetor	2030	euro	34.000.00
38	30 qershor	2031	euro	34.000.00
39	30 dhjetor	2031	euro	34.000.00
40	30 qershor	2032	euro	34.000.00
41	30 dhjetor	2032	euro	34.000.00
42	30 qershor	2033	euro	34.000.00
43	30 dhjetor	2033	euro	34.000.00
44	30 qershor	2034	euro	34.000.00
45	30 dhjetor	2034	euro	34.000.00
46	30 qershor	2035	euro	34.000.00
47	30 dhjetor	2035	euro	34.000.00
48	30 qershor	2036	euro	34.000.00
49	30 dhjetor	2036	euro	34.000.00
50	30 qershor	2037	euro	34.000.00
51	30 dhjetor	2037	euro	34.000.00
52	30 qershor	2038	euro	34.000.00
53	30 dhjetor	2038	euro	34.000.00
54	30 qershor	2039	euro	34.000.00
55	30 dhjetor	2039	euro	34.000.00
56	30 qershor	2040	euro	34.000.00
57	30 dhjetor	2040	euro	34.000.00
58	30 qershor	2041	euro	34.000.00
59	30 dhjetor	2041	euro	34.000.00
60	30 qershor	2042	euro	39.167.52
	TOTAL	euro		2.045.167,52

4.5 Nëse ndonjë nga këstet e shlyerjes nuk është në dispozicion të KfW-së në kohën e duhur, KfW-ja mund të rrisë normën e interesit të pagesave të vonuara në përqindjen bazë, plus 3 % në vit për një periudhë duke filluar nga data e caktuar dhe përfunduar në datën në të cilën janë kredituar këto shlyerje në llogarinë e KfW-së, specifikuar në nenin 4.9. "Përqindja bazë" është përqindja e interesit të caktuar nga Deutsche Bundesbank, si përqindje bazë në përqindjen e aplikueshme në datën përkatëse. Në rastin e interesave të vonuara, KfW-ja, mund të kërkojë dëmshpërblim. Ky dëmshpërblim nuk mund të kalojë shumën e mbërritur, nëse interesi është caktuar mbi këtë interes të prapambetur, në përqindjen bazë mbizotëruese në datën e caktuar plus 3 % në vit.

4.6 Detyrimi i angazhimit, interesi dhe ndonjë detyrim i prapambetur sipas nenit 4.5 do të llogaritet bazuar në vitin me 360 ditë ose në muajin me 30 ditë.

4.7 Shuma e huasë së shlyer para kohe ose e padisbursuar duhet të kreditohet në sasi të barabarta përkundrejt të gjitha kësteve të shlyerjeve të papaguara derisa KfW-ja me dëshirën e saj të caktojë një metodë të ndryshme shlyerje në një rast të veçantë, veçanërisht në rastin e shumave për volume më të pakta.

4.8 KfW-ja ka të drejtë të kreditojë, sipas zgjedhjes së saj, pagesat e marra kundrejt pagesave për t'u paguar sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të tjera të huave të konkluduara ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

4.9 Huamarrësi do t'i dërgojë të gjitha pagesat në monedhën e Republikës Federale të Gjermanisë në llogarinë e KfW-së nr. 22560801 në Kreditanstalt fur Wiederaufbau Frankfurt am Main (BLZ 500 204 00, SWIFT; KFWIDEFF), nuk lejohet asnjë kundërkërkesë kundrejt pagesave të tilla.

Neni 5
Ndërprerja e disbursimeve dhe shlyerjeve parakohe

5.1 Huamarrësi në çdo kohë:

a) në varësi të realizimit të detyrimeve të tij sipas nenit 8, mund të anulojë çdo shumë huaje të padisbursuar akoma;

b) mund të shlyejë huanë të gjithën ose në pjesë para maturimit.

5.2 KfW-ja nuk mund të ndërpresë disbursimet përveçse kur:

a) Huamarrësi nuk arrin të përmbushë detyrimet ndaj KfW-së për të bërë pagesat në kohën e duhur;

b) detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta, që lidhen me këtë Marrëveshje janë shkelur;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit është e paaftë të provojë që huaja ose shumat e kontributit financiar janë përdorur për qëllimin e caktuar;

d) janë krijuar rrethana të jashtëzakonshme, që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, veprimin ose qëllimin e Projektit ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës së pretenduar nga Huamarrësi/ Marrësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.3 Në qoftë se ndonjë nga situatat e specifikuara në nenin 5.2 a), b) ose c) ka ndodhur dhe nuk është shmangur brenda një periudhe të caktuar nga KfW-ja, e cila do të jetë së paku 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastin e përcaktuar në nenin 5.2 a) ose 5.2 b), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të papaguara të huasë, si dhe pagesën e të gjithë interesit që rrjedh dhe të gjitha detyrimeve të tjera të rastësishme;

b) në rastin e përcaktuar në nenin 5.2 c), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të shumave të kësaj huaje ose të kontributit financiar, pasi Agjencia e Zbatimit të Projektit është e paaftë të provojë se ato janë përdorur për qëllimin e caktuar.

Neni 6
Kostot dhe shpenzimet publike

6.1 Huamarrësi do të kryejë të gjitha pagesat, që do të bëhen sipas kësaj Marrëveshjeje, pa ndonjë zbritje për taksat, detyrime të tjera publike ose kosto të tjera dhe do të paguajë kostot e transferimit dhe shkëmbimit që ndodhin në lidhje me disbursimet e huasë / kontributit financiar.

6.2 Huamarrësi do të përballojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që veprojnë jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me përfundimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7
Fuqia ligjore e kësaj Marrëveshje dhe përfaqësimi

7.1 Në kohën e duhur, para disbursimit të parë, Huamarrësi do të pajisë KfW-në me një evidencë të pranueshme për KfW-në, që vërteton se Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas

ligjeve të tij konstitucionale dhe ligjeve të tjera për marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes.

7.2 Ministri i Financave dhe persona të tillë të ngarkuar nga ai ose ajo për KfW-në dhe autorizuar me specimen të firmave të mirëfillta nga ai ose ajo, do të përfaqësojnë Huamarrësin në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori Ekzekutiv i Fondit të Zhvillimit Shqiptar dhe persona të tillë të ngarkuar nga ai ose ajo për KfW-në dhe autorizuar me specimen të firmave të mirëfillta nga ai ose ajo, do të përfaqësojnë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk do të përfundojë deri në kohën që shprehja e revokimit nga përfaqësuesit e autorizuar është marrë nga KfW-ja.

7.3 Amendamente ose shtesa të kësaj Marrëveshjeje dhe ndonjë shënim ose deklaratë nga Palët Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje do të jenë me shkrim. Çdo shënim ose deklaratë e tillë do të merret sapo të arrijë në adresën e mëposhtme të Palës Kontraktuese përkatëse ose në adresën tjetër të Palës Kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar Palës tjetër Kontraktuese:

Për KfW
Kreditanstalt für Wiederaufbau
Postfach 111141
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale e Gjermanisë
Telefax: +49- (0)69-74 31 -2944
Telex: 4 15 25 60 KfW d

Për Huamarrësin
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Telefax: +355-28494

Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit:
Fondi i Zhvillimit Shqiptar
Rr. e Durrësit, Instituti i Tokave
Laprakë /Tiranë
Republika e Shqipërisë
Telefax: + 355-42-34885

7.4 Ndryshimet në këtë Marrëveshje, që prekin vetëm marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit, nuk do të kërkojnë miratimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

Neni 8

Projekti:

8.1 Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe mirëmbajë projektin në përputhje me praktika inxhinierike dhe financiare të qëndrueshme dhe thellësisht në përputhje me konceptimin e projektit, për të cilin është rënë dakord mes Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së;

b) do të japë kontrata:

- për pajisje materiale që do të financohen nga kredia dhe që i kalojnë US $ 50,000.00 pas një tenderi ndërkombëtar;
- për punime civile që do të financohen nga huaja dhe që i kalojnë US $ 50,000.00 pas një tenderi konkurrues të kufizuar për firmat që veprojnë në Shqipëri;
- për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja me një vlerë kontrate deri në US $ 50,000.00 sipas vlerësimit paraprak të çmimeve;
- për shërbime konsulence, që do të financohen nga kontributi financiar pas një tenderi konkurrues të kufizuar të paktën mes firmave që veprojnë në Gjermani.

c) do të mirëmbajë ose do të kërkojë të mirëmbahen librat dhe shënimet, duke treguar pa mëdyshje të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe duke identifikuar qartë mallrat dhe shërbimet financuar nga kjo hua/kontributi financiar;

d) do t'u mundësojë përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë, të kontrollojnë librat dhe shënimet, si dhe çdo/ose të gjitha dokumentet e tjera që lidhen me zbatimin e Projektit dhe të vizitojë Projektin dhe të gjitha instalimet lidhur me të;

e) do të pajisë KfW-në me çdo/ose të gjitha informacionet dhe relacionet mbi

projektin dhe progresin e tij në vazhdim siç mund të kërkohet nga KfW-ja.

8.2 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë që i referohen nenit 8.1 në një marrëveshje të veçantë.

8.3 Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimt të Projektit:

a) do të sigurojë financimin e plotë të projektit dhe, sipas kërkesës, të pajisë KfW-në me evidencën që provon se kostot e papaguara nga kjo hua/kontribut financiar janë mbuluar dhe,

b) sipas marrëveshjes së tyre të informojë menjëherë KfW-në për çdo/ose të gjitha rrethanat që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit.

8.4 Huamarrësi do të ndihmojë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në përputhje me praktika të qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në zbatimin e projektit dhe në përmbushjen e detyrimeve nga Agjencia e Zbatimit të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, t'i japë Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndonjë dhe të gjitha lejet e domosdoshme për zbatimin e Projektit.

8.5 Për transportin e mallrave që do të financohen nga huaja/kontributi financiar, do të zbatohen dispozitat e Marrëveshjes Qeveritare, të cilat janë të njohura për Huamarrësin.

Neni 9

Dispozita të ndryshme

9.1 Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit duhet të garantojnë që personat, të cilët janë ngarkuar për përgatitjen dhe zbatimin e Projektit, dhënien e kontratës për pajisje dhe shërbime për t'u financuar dhe me kërkimin e disbursimeve të shumave të huasë/kontributit financiar, nuk do të kërkojnë, pretendojnë, japin, premtojnë ose t'u premtohen pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

9.2 Në qoftë se ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera nuk do të influencohen nga kjo. Çdo boshllëk, që do të rezultojë nga kjo, do të plotësohet nga një dispozitë e përshtatshme me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk duhet të nënshkruajnë ose transferojnë garanci ose hipotekim që ndonjë mund t'i pretendojë nga kjo Marrëveshje.

9.4 Kjo Marrëveshje do të udhëhiqet nga ligji i Republikës Federale Gjermane. Vendi i përfundimit do të jetë Frankfurt am Main. Në rast dyshimi në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, do t'i referohet tekstit gjermanisht.

9.5 Të gjitha kontradiktat që rrjedhin nga kjo Marrëveshje dhe të gjitha polemikat mbi vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje dhe të Marrëveshjes së Arbitrazhit, që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet Palëve Kontraktuese, duhet të paraqiten në seancat e arbitrazhit sipas Marrëveshjes së Arbitrazhit, që përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

9.6 Kjo hua dhe Marrëveshje projekti nuk do të hyjë në fuqi deri sa të hyjë në fuqi Marrëveshja Qeveritare në të cilën ajo është bazuar.

Shkruar në gjashtë kopje origjinale, tri në gjermanisht dhe tri në anglisht.

KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU
Frankfurt am Main,
Më 5.10.2002

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I FINANCAVE
KASTRIOT ISLAMI

MARRËVESHJA E ARBITRAZHIT

REFERUAR NENIT 9.5 TË MARRËVESHJES SË HUASË, FINANCIMIT DHE PROJEKTIT NDËRMJET KREDITANSTALT FUR WIEDERAUFBAU, FRANKFURT AM MAIN ("KFW") DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ("HUAMARRËSI")
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE FONDI I ZHVILLIMIT SHQIPTAR ("AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT") PËR 2.045.167,52 EURO SI KREDI DHE 255.645, 94 EURO SI KONTRIBUT FINANCIAR

Fondi i investimeve sociale, II

KfW-ja, Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit tani e tutje bien dakord për sa më

poshtë:

Neni 1

Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga Marrëveshja e financimit të huasë dhe projektit dhe të gjitha mosmarrëveshjet mbi vlefshmërinë e Marrëveshjes së financimit të huasë dhe projektit dhe të Marrëveshjes së Arbitrazhit që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim nga Palët Kontraktuese, do të zgjidhen përfundimisht dhe vetëm nga Gjykata e Arbitrazhit.

Neni 2

Palët në seancat e arbitrazhit do të jenë Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit nga njëra anë dhe KfW-ja nga ana tjetër. KfW-ja ka të drejtën të bëjë padi kundër Huamarrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit veçmas ose së bashku. Në mënyrë të ngjashme Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit kanë të drejtën që veçmas ose bashkë të paraqesin një padi kundër KfW-së.

Neni 3

3.1 Gjykata e Arbitrazhit përbëhet nga tre gjyqtarë të emëruar si më poshtë: një gjyqtar do të emërohet nga vetë Huamarrësi ose, në rast se Huamarrësi nuk ndërhyn ose nuk ka ndërhyrë akoma në proces, nga Agjencia e Zbatimit të Projektit; gjykatësi i dytë nga KfW-ja dhe një gjyqtar i tretë ("kryetari") do të emërohet me marrëveshje nga Palët ose, nëse Palët nuk arrijnë brenda 60 ditëve pas marrjes së kërkesës për arbitrazh nga mbrojtësi, me kërkesë të çdo njërës Palë, nga Presidenti i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, ose, në rast dështimi të emërimit nga ai, nga Kryetari i Komitetit Kombëtar Zvicerian të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Në rast se ndonjë nga Palët nuk arrin të emërojë një gjykatës, ky gjykatës do të emërohet nga kryetari.

3.2 Në rastin kur ndonjë gjykatës i emëruar, sipas dispozitave të mësipërme, heq dorë ose bëhet i paaftë për të vepruar si gjykatës, pasardhësi i tij do të emërohet në të njëjtën mënyrë si gjykatësi i parë. Pasardhësi do të ketë të gjitha fuqitë ligjore dhe përgjegjësitë e gjykatësit të parë në fjalë.

Neni 4

4.1 Procesi i arbitrazhit do të fillojë nga paraqitja me shkrim e një ankese nga njëra Palë për tjetrën. Një ankesë e tillë duhet të përcaktojë natyrën e pretendimit, mënyrën e zgjedhjes ose kompesimin e kërkuar, emrin e gjykatësit të caktuar nga paditësi, nëse paditësi është i autorizuar të emërojë një gjykatës sipas nenit 3.1.

4.2 Brenda 30 ditëve nga marrja e një ankese të tillë, Pala e paditur duhet të njoftojë paditësin për emrin e gjyqtarit të emëruar nga ai, nëse është i autorizuar të emërojë një gjyqtar sipas nenit 3.1.

Neni 5

Gjykata e Arbitrazhit do të mblidhet në kohën që do të caktohet nga Kryetari. Në rast se Palët nuk bien dakord për vendin e seancave të arbitrazhit, ky vend do të vendoset nga Kryetari.

Neni 6

Gjykata e Arbitrazhit vendos mbi bazën e kompetencës së saj. Ajo do të përcaktojë procedurat e saj sipas rregullave në përgjithësi të njohura të procedurës. Në çdo rast Palëve do t'u lejohet dëgjimi gojor në një seancë të rregullt. Gjykata e Arbitrazhit mund të marrë vendim, pavarësisht nëse njëra nga Palët nuk paraqitet. Të gjitha vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit kërkojnë miratimin e të paktën dy gjyqtarëve.

Neni 7

Gjykata e arbitrazhit do të dërgojë vendimin së bashku me arsyetimet e saj me shkrim. Një vendim i nënshkruar nga të paktën dy gjyqtarë përbën vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit. Secila Palë do të marrë një kopje të nënshkruar të vendimit. Vendimi do të jetë detyrues dhe përfundimtar. Nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, të dyja Palët marrin përsipër detyrimet për të përmbushur këtë kontratë.

Neni 8

8.1 Palët bien dakord për shpërblimin e gjyqtarëve dhe personave të tillë për drejtimin e seancave të arbitrazhit ashtu siç do të kërkohet.

8.2 Në rast se Palët nuk arrijnë të bien dakord për këtë para hapjes së seancës së Gjykatës të Arbitrazhit, ajo cakton vetë një shpërblim të arsyeshëm. Secila Palë do të përballojë nga ana e saj shpenzimet e arbitrazhit dhe kostot e arbitrazhit duhet të paguhen nga pala kundër së cilës është dhënë vendimi. Në rast se vendimi nuk është në favor të asnjërës Palë, kostot duhet të paguhen nga Palët në mënyrë proporcionale.

8.3 Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë përfundimisht mbi të gjitha çështjet që lidhen me kostot.

8.4 Palët do të jenë të detyruara veçmas ose bashkërisht për pagesën e shpërblimit të personave specifikuar në nenin 8.1.

Neni 9

Çdo ose të gjitha shënimet dhe vendimet e shpërndara nga Palët dhe Gjykata e Arbitrazhit, lidhur me seancat e arbitrimit, duhet të jenë me shkrim. Vendime ose shënime të tilla duhet të merren sapo ato të arrijnë në adresën e mëposhtme të Palës Kontraktuese korresponduese ose në një adresë tjetër, siç i është njoftuar Palës tjetër Kontraktuese.

Për KfW-në
Kreditanstalt für Wiederaufbau
Postfach 111141
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale e Gjermanisë
Telefax: +49- (0)69-74 31 -2944
Telex: 4 15 25 60 Kwd

Për Huamarrësin
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Telefax: +355-42-28494

Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit:
Fondi i Zhvillimit Shqiptar
Rr. Durrësit, Instituti i Tokave
Laprakë /Tiranë
Republika e Shqipërisë
Telefax: + 355-42-34885

Përgatitur në gjashtë kopje origjinale, tri në gjermanisht dhe tri në anglisht.

Frankfurt am Main,
Më 5.10.2002

KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I FINANCAVE
KASTRIOT ISLAMI